



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 400 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

**VENDIM Nr. 58 datë 04.06.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin e ri "Përditësimi dokumentacionit - Therma romake - Butrint (rivlerësim arkeologjik dhe menagjim i sitit)"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues i tij Prof. Luan Përzhita,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë *Projektin e ri "Përditësimi dokumentacionit - Therma romake - Butrint (rivlerësim arkeologjik dhe menagjim i sitit)"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues i tij Prof. Luan Përzhita, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Kryerja e Survey-t dhe dokumentimi i fazave ndërtimore të mureve që ruhen në këtë zonë.
- II. Periudha kohore e kryerjes së Survey-t do të jetë brenda vitit 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**